



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE “HYSEN ÇELA” DURRES

Nr. 918 prot.

Durrës 14.11.2023

Lënda: Njoftim për vend te lirë

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr.14 datë 27.05.2021 ..., “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

Shkolla e mesme teknologjike “Hysen Çela” ju njofton krijimin e vendit të pjesshëm për pozicionin

- Pozicioni: mësues me 10 orë i praktikës profesionale drejtimi Detari

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

I. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

II. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

1. Kriteret e posacme per personelin mesimdhene te praktikes profesionale ne ofruesin e AFP-seqe ofrojne arsim profesional .

- a) Te kete te paktën diplome nga nje shkolle e mesme profesionale ne te njejtën fushe me kualifikimin /kualifikimet profesionale te ofruesit te AFP-se ,per te cilin /cilat po aplikon .
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a - letërmotivimin për pozicionin;
- b- jetëshkrimin (CV-në);
- c- kartën e identitetit;
- d- diplomën;
- e- librezën e punës;
- f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k - të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e shkolles se mesme teknologjike "Hysen Çela", brenda dates 04.12.2023

Njoftim per levizje paralele nuk u paraqit asnje dosje

DREJTORE

Dr. Blerina DERVISHI

